



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 pragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10¹ dhe 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-99 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-99 datë 17.3.2023, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1188/8 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023 miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive HARAÇINA SHPKNJP f. Haraçinë, nr.08-67 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzion, ark.nr.02-1007/8 datë 8.3.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-99 datë 7.3.2023 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive HARAÇINA SHPKNJP f. Haraçinë, nr.08-67 datë 5.1.2015, për faktin se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1003/1 datë 3.3.2023, u konstatua se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës e dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, respektivisht nuk ka paguar kompensim (tarifë) vjetore për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më 9.3.2023, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-99 datë 9.3.2023, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin (tarifën) vjetore për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do sjellë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 17.3.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për financa dhe logjistikë është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-1003/2 datë 17.3.2023. se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive HARAÇINA SHPKNJP f. Haraçinë, më 17.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 178.808,00 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetë) denarë, me të cilën kompensimin (tarifën) vjetore për lejen e transmetimit në radio e pagoi plotësisht.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi 1 nënparagrafët 1, 10 dhe 13 nga Ligji për Shërbime

Уп1 Бр.08-99

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-99 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-99 datë 17.3.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1188/8 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

¹ Алинеите 8 и 9 се избришани, види: член 8 од Закон за изменување и дополнување на Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија” бр.248/18).